

Buletini i Financave Publike – Mars 2017

nga Instituti për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen

Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë publikoi Statistikat fiskale për muajin Mars 2017. Në shërbim të analizës janë përdorur të dhënat kumulative për të ardhurat publike, shpenzimet qeveritare dhe investimet nga Shkurti 1998 deri në Mars 2017.

Duke analizuar ecurinë e financave publike, Presidenti i Nderit të IPPM-së, Z. Arben Malaj, shprehet:

“Gjatë muajit Mars 2017, realizimi i të ardhurave vjetore ka shënuar jo vetëm përmirësimin në raport me të njëjtën periudhë të vitit 2016, por, referuar Indeksit të IPPM-së, edhe në raport me mesataren e periudhës 10-vjeçare. Edhe treguesit kumulativ të të ardhurave të realizuara tregojnë përmirësim. Shpenzimet totale të realizuara gjatë muajit Mars kanë treguar gjithashtu përmirësim krahasuar si me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ashtu edhe me mesataren e 10 viteve të fundit për këtë periudhë. Ndërsa përsa i përket treguesve kumulativë të shpenzimeve totale, përmirësimi ka qenë vetëm krahasuar me vitin e kaluar, por jo me periudhën 10-vjeçare. Ecuria e investimeve publike të muajit Mars, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me atë të 10 viteve të fundit, ka qenë e njëjtë si ajo e shpenzimeve totale.”.

Krahasimet kryesore:

Të ardhurat publike për muajin Mars 2017 shënuan vlerën 37,464 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, vihet re një rritje në vlerë nominale prej 2,551 miliardë lekësh ose një rritje prej 7.3 %.

Gjatë muajit Mars, të ardhurat e realizuara si pjesë e të ardhurave totale të planifikuara për Buxhetin e vitit 2017 ishin 8.58 %. Referuar peshës mesatare të të ardhurave të realizuara për muajin Mars të 10 viteve të fundit, rezulton se ajo është në vlerën 8.38 %. Pra, realizimi i të ardhurave për Mars 2017 ka rezultuar më mirë se mesatarja e periudhës 10 vjeçare, konkretisht me një diferencë prej 0.20 pikë përqindje.

Shpenzimet totale për muajin Mars arritën vlerën 39,326 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 7,567 miliardë lekësh në vlerë nominale, ose një rritje prej 23.8 %..

Për muajin Mars, pesha mesatare e shpenzimeve totale ndaj Buxhetit të këtij viti ka rezultuar 8.41 %, ndërsa pesha mesatare e 10 viteve të fundit për këtë tregues ka qenë 7.39 %. Në këtë aspekt mund të thuhet se shpenzimet totale për Marsin e vitit 2017 kanë rezultuar më lartë se mesatarja e periudhës 10 vjeçare, duke pësuar një rritje prej 1.02 pikë përqindje.



Instituti për Politikat Publike dhe
Mirëqeverisjen

Web: www.ippm.al

E-mail: secretary@ippm.al

*për t'u bërë pjesë e listës
prioritare ju lutem na shkruani në
secretary@ippm.al*

Kryetar i Bordit:
Arlind Rama

Drejtor Ekzekutiv
Ledjon Shahini

Regjistruar ne Gjykatën e Tiranës,
Nr regjistrimi 389

Adresa: Rruga e Elbasanit Nr. 8,
Godina e KU Luarasi, Kati IV
Tiranë, Shqipëri

Investimet publike gjatë muajit Mars arritën vlerën 7,101 miliardë lekë. Krahasuar me të njejtin muaj të një viti më parë, investimet publike mujore shënuan një rritje në vlerë nominale prej, 2,275 miliardë lekë, ose një rritje prej 47.1 %, shkaktuar tërësisht nga investimet me financim të brendshëm.

Analizë e mëtejshme e treguesve

Mbi bazën e të dhënave zyrtare të statistikave fiskale të publikuara nga Ministria e Financave është përgatitur një analizë më e fokusuar e treguesve kryesorë të financave publike.

Të ardhurat në buxhetin e shtetit

Totali i të ardhurave për muajin Mars 2017 shënoi vlerën 37,464 miliardë lekë, apo 2,551 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Rritja prej 7.3 % e të ardhurave të realizuara në terma vjetorë është shkaktuar tërësisht nga rritja e të ardhurave tatimore, të cilat kanë pësuar rritje me 7.6 %, osë një rritje prej 2,454 miliardë lekësh në vlerë nominale. Ndërsa realizimi i të ardhurave nga ndihmat ka rezultuar më dobët krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar një rënie prej 160 milionë lekësh, apo një rënie prej 18 %.

Pesha mesatare e të ardhurave nga ndihmat për Marsin e vitit 2017 ndaj Buxhetit të këtij viti ka qenë 5.27 %, ndërsa pesha mesatare për Marsin e 10 viteve të fundit ka qenë 5.14 %, duke shënuar kështu një rritje prej 0.13 pikë përqindje.

Pesha mesatare e të ardhurave tatimore për Marsin e këtij viti ka rezultuar 8.76 %, ndërsa pesha mesatare e periudhës 10 vjeçare për këtë tregues ka qenë 8.48 %, duke shënuar një rritje prej 0.28 pikë përqindje.

Sipas Indeksit të IPPM, në muajin Mars, të ardhurat e realizuara si peshë e Buxhetit 2017 janë 0.21 pikë përqindje më lart se pesha mesatare e të ardhurave të realizuara për muajin Mars gjatë 10 viteve të fundit.

Të dhënat kumulative tregojnë se gjatë 3-mujorit të parë të 2017 janë arkëtuar 101,485 miliardë lekë, një rritje prej 4,847 miliardë lekë ose 5.02 % më shumë se gjatë të njëjtës periudhë për vitin 2016. Ndërsa si peshë ndaj totalit të ardhurave për vitin 2017, të ardhurat kumulative për 3-mujorin e parë të këtij viti arrijnë në 23.26 %.

Referuar Indeksit të IPPM-së, rezulton se pesha mesatare e të ardhurave të realizuara gjatë 3-mujorit të parë të këtij viti është 0.31 pikë përqindje më lart se pesha mesatare për periudhën 2007-2016, e cila është në vlerën 22.95 %.



Instituti për Politikë Publike dhe
Mirëqeverisjen

Web: www.ippm.al

E-mail: secretary@ippm.al

*për t'u bërë pjesë e listës
prioritare ju lutem na shkruani në
secretary@ippm.al*

Kryetar i Bordit:
Arlind Rama

Direktor Ekzekutiv
Ledjon Shahini

Regjistruar ne Gjykatën e Tiranës,
Nr regjistrimi 389

Adresa: Rruga e Elbasanit Nr. 8,
Godina e KU Luarasi, Kati IV
Tiranë, Shqipëri

Shpenzimet totale

Për muajin Mars 2017, shpenzimet totale shënuan vlerën prej 39,326 miliardë lekë duke pësuar një rritje prej 7,567 miliardë lekësh në vlerë nominale, ose një rritje prej 23.8 % krahasuar me Marsin e 2016, ndër të cilat 5,323 miliardë lekë kanë qënë nga rritja e shpenzimeve korrente. Shpenzimet korrente kanë rezultuar në vlerën 32,104 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 19.9 % krahasuar me një të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm, shkaktuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve për Buxhetin Vendor në masën 71.8 %, e shprehur kjo në vlerë nominale, 2,146 miliardë lekë më shumë.

Pesha e shpenzimeve totale të realizuara gjatë muajit Mars 2017 ndaj totalit të këtyre shpenzimeve për këtë vit ka rezultuar 1.02 pikë përqindje më lart se pesha mesatare për 10 vitet e fundit. Pesha e shpenzimeve korrente për muajin Mars ndaj Buxhetit të këtij viti ka qënë 8.23 %. Referuar Indeksit 10-vjeçar të IPPM-së, rezulton se pesha e shpenzimeve korrente të realizuara gjatë Mars ndaj Buxhetit për 2017 është 0.76 pikë përqindje nën mesataren 10 vjeçare të shpenzimeve korrente për muajin Mars.

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2017, shpenzimet totale arritën në nivelet e 93,934 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 10,657 miliardë lekësh ose 12.8 % më shumë krahasuar me periudhën Janar- Mars 2016.

Pesha e shpenzimeve publike të realizuara gjatë 3-mujorit të parë për këtë vit ndaj Buxhetit për vitin 2017 arriti vlerën prej 20.09 % dhe 0.15 pikë përqindje nën vlerën e indeksit kumulativ për periudhën Janar - Mars të 10 viteve të fundit.

Investimet publike

Investimet publike në muajin Mars 2017 arritën vlerën nominale 7,101 miliardë lekë, ose 2,275 miliardë lekë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritja prej 47.1 % e investimeve publike ka ardhur tërësisht nga investimet me financim të brendshëm, të cilat kanë qënë në vlerën 5,840 miliardë lekë, duke shënuar kështu një rritje prej 64.7 % krahasuar me muajin Mars të vitit 2016. Ndërsa investimet publike me financim të jashtëm kanë qënë në vlerën 1,261 miliardë lekë, duke shënuar një rënie prej 1.5 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Pesha e investimeve publike për muajin Mars ndaj Buxhetit të vitit 2017 rezulton 9.54 %, ndërsa referuar Indeksit të IPPM-së, rezulton se pesha mesatare e investimeve publike të realizuara gjatë muajve Mars për 10 vitet e fundit është 7.84 %. Kjo nënkupton një rritje të këtij treguesi në masën 1.7 pikë përqindje.

Referuar statistikave kumulative për Janar-Mars 2017, investimet publike gjatë kësaj periudhe arritën në 10,192 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 2,927 miliardë lekë ose 40.29 % më shumë krahasuar me investimet publike të kryera gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2016.

Referuar Indeksit të IPPM-së, rezulton se pesha mesatare e investimeve publike si kumulativ i Janar – Mars për periudhën 2007 – 2016 është 16.76 %, ndërsa për vitin 2017 arrin në 13.69 % ,duke shënuar një rënie të këtij treguesi prej 3.07 pikë përqindje krahasuar me mesataren e 10-vjeçarit.



Instituti për Politikë Publike dhe
Mirëqeverisjen

Web: www.ippm.al

E-mail: secretary@ippm.al

*për t'u bërë pjesë e listës
prioritare ju lutem na shkruani në
secretary@ippm.al*

Kryetar i Bordit:
Arlind Rama

Drejtor Ekzekutiv
Ledjon Shahini


Regjistruar ne Gjykatën e Tiranës,
Nr regjistrimi 389

Adresa: Rruga e Elbasanit Nr. 8,
Godina e KU Luarasi, Kati IV
Tiranë, Shqipëri


Analiza Grafike e Buletinit të Financave Publike - Mars 2017

1. Të ardhurat në Buxhetin e Shtetit


Të Ardhurat Totale dhe Indeksi i IPPM
Mil Lekë




Pesha e të ardhurave mujore dhe Pesha mesatare e 10 - vjeçarit




Të Ardhurat Mujore
Mil lekë




Pesha e Të Ardhurave Mujore









Të Ardhurat Kumulative
Mil lekë









Pesha e të Ardhurave Kumulative



2. Shpenzimet Totale



3. Investimet Publike



FALEMINDERIT!

Për të marrë në kohë reale Buletinin e Financave Publike ju lutem na kontaktoni në secretary@ippm.al.

Informacione të mëtejshme në lidhje me analizën e përgatitur për Buletinin e Financave Publike mund të gjenden në:

Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje

www.ippm.al/buletiniifinancavepublike

Ministria e Financave, Statistikat mujore fiskale

www.minfin.gov.al